

Shoqata e kontabilistëve të çertifikuar dhe auditorëve të Kosovës
Society of Certified Accountants and Auditors of Kosovo

**Auditim
(me zgjidhje)**

P6

Data 03/10/2020

Detyra 1

Nano është një organizatë jofitimprurëse statuti i së cilës kërkon që organizata të mbledhë fonde për projekte të edukimit. Këto projekte tentojnë të edukojnë fëmijët dhe të mbështesin mësuesit në vende të ndryshme. Organizatat jofitimprurëse nga vendi i cili është regjistruar Nano në kohën e fundit i janë nënshtruar një rregulloreje të re të auditimit dhe kontabilitetit. Të hyrat e organizatës përbëhen nga të hyrat nga para të gatshme dhe nga ngjarjet e organizuara për grumbullimin e fondeve, kërkesave përmes telefonit dhe trashëgimitë (pasuria e lënë trashëgimi nga personat e vdekur). Organizata është e vogël dhe anëtarët e bordit nuk mendojnë se organizata ka fonde të mjaftueshme të punësojë një kontabilist të kualifikuar. Organizata punëson një kontabilist të pakualifikuar me gjysëm orari dhe mbështetet tek vullnetarët për të grumbulluar fonde. Firma e juaj është emëruar si auditor i organizatës për shkak të rregullativës së re. Pasqyrat financiare janë përgatitur (por nuk janë audituar) në të kaluarën nga një vullnetar i cili është kontabilist i certifikuar në pension.

Kërkohet

- (a) Përkrahuri rrezikun e shoqëruar me auditimin e Nano të ndarë në rrezikun e vetëvetishëm, rrezikun e kontrollit dhe rrezikun e moszbulimit dhe shpjegoni implikimet e këtyre rreziqeve në rrezikun e përgjithshëm të auditimit. **(10 pikë)**
- (b) Listoni dhe shpjegoni testet e auditimit që duhet të kryhen në të hyrat dhe shpenzimet nga ngjarjet për grumbullimin e fondeve. **(10 pikë)**

Shënim. Nuk kërkohet të merreni me detajet e kontabilitetit për organizatat jofitimprurëse në asnjërin pjesë të pyetjeve. **(Total = 20 pikë)**

Zgjidhja

(a) Rreziqet

REZIQET E VETËVETISHME DHE TË KONTROLLIT (RREZIKU I ANOMALISË MATERIALE) Kompleksiteti dhe shtrirja e rregulloreve

Ekziston rreziku se organizata do të dështojë në pajtueshmërinë me rregulloret ekzistuese. Poashtu organizata mund të jetë e involvuar në aktivitete që nuk janë të përshtatshme për organizata të bamirësisë.

Ky mund të rasti sidomos në organizata të vogla si Nano e cila udhëhiqet nga individët që nuk e kanë ekspertizën e duhur. Fakti që PF janë përgatitur nga një kontabilist i pensionuar së voni do të duhej të zvogëlonte vlerësimin e auditorit sa i përket këtij rreziku.

Plotësia e të hyrave

Ekziston rreziku se të hyrat mund të jenë të keqpohuara. Ky rrezik rritet nga nivelet e donacioneve me para të gatshme të cilat mund të mos mbështeten me dëshmi të dokumentuara. Paraja mund të keqpërdoret ose mund të ndodhin gabime gjatë numërimit dhe regjistrimit. Plotësia e të hyrave nga aktivitetet e hapura ku individët dhurojnë para do të ishte poashtu e vështirë të konfirmohet sepse nuk ka ndonjë model të parashikueshëm të pranimit të këtyre parave.

Pasiguria e të hyrave në të ardhmen

Për shkak të natyrës së paparashikueshme të të hyrave ekziston rreziku se organizata mund të ndërmerr projekte të cilat më pas nuk mund t'i financojë. Ky faktor poashtu do të bëjë të vështirë për auditorin të vlerësojë nëse organizata është e qëndrueshme në bazë të vazhdueshme.

Aftësitë dhe kualifikimet e bordit

Rreziku u kontrollit rritet nëse anëtarët e bordit nuk kanë aftësitë e kërkuara për të menaxhaur punët e organizatës. Ky rrezik poshtu ndikohet se në ç'masë dhe sa kohë këta anëtarë të bordit janë të involvuar në punët e organizatës.

Përdorimi i vullnetarëve

Rreziku i kontrollit rritet me përdorimin e vullnetarëve. Organizata varet nga integriteti dhe përkushtimi i tyre. Mund të ketë pengesa në aktivitete nga mungesa e trajnimit dhe sjellja e vullnetarëve. Vullnetarët fals mund të kryejnë mashtrime.

Cilësia e stafit që paguhet

Mungesa e burimeve mund të rezultoj që të punësohet staf që nuk janë të kualifikuar në mënyrë të mjaftueshme. Në rastin e Nano një kontabilist me orar jo të plotë është punësuar në vend të një kontabilisti me orar të plotë. Nëse ky individ është nën presion konstant, rreziku i gabimeve mund të rritet.

Mungesa e procedurave formale

Ekziston rreziku që për shkak të mjedisit të dobët të kontrollit organizatat të menaxhohet keq. Ky problem ka mundësi të ndodhë për shkak të mungesës së ndarjes së detyrave për shkak të numri të vogël të të punësuarve.

RREZIKU I MOSZBULIMIT

Angazhimi i parë

Rreziku i zbulimit rritet nga fakti se firma është caktuar së voni për të ofruar shërbimet. Ekipi i auditimit nuk do të jetë në gjendje të mbështetet në përvojën nga viti i kaluar. Përveç kësaj, rregulloret tani janë të reja. Ekziston rreziku se auditorët do të dështojnë të kryejnë procedurat specifike që kërkojnë nga rregulloret për shkak se nuk janë të familjarizuar me ato rregullore.

Mbështetje e vogël në procedura analitike

Për shkak të natyrës së paparashikueshme të të hyrave mund të jetë e vështirë të mbështeten në procedurat analitike për të vlerësuar plotësinë e të hyrave. Kjo rritë rrezikun e zbulimit pasi që procedurat analitike janë njëra nga testet kyçe në këtë fushë.

Implikimet për rrezikun e përgjithshëm të auditimit

Qëllimi i auditorit është të zvogëlojë rrezikun e përgjithshëm të auditimit në një nivel të arsyeshëm. Rreziku i auditimit është funksion i rrezikut të anomalive materiale dhe rrezikut të zbulimit. Pasi që rreziku i vetvetishëm dhe i kontrollit në Nano duket se janë të larta/mesme rreziku i zbulimit duhet të jetë i ulët. Kjo mund të arrihet përmes rritjes së punës në auditim psh përmes rritjes së mostrës.

(b) Testet e auditimit

Të hyrat

- Pjesëmarrja në ngjarjet për grumbullimin e fondeve dhe vëzhgimi i procedurave për të konfirmuar se ato janë në pajtueshmëri me udhëzimet e parapara nga organizata
- Numërimi i parasë në fund të ditës dhe përputhja me dokumentet e dorëzuara nga vullnetarët.
- Përputhja e dokumenteve të dorëzuara me shumat në dëftesat e pagesës.
- Gjurmimi i regjistrimit të parasë në librin e arkës deri në raportin e bankës.
- Rishikimi i përgatitjes së harmonizimit mujor bankar.
- Krahasoni i shumave të pranuar përmes grumbullimit të parasë me saldot e vitit të kaluar dhe parashikimet. Diskutimi i luhatjeve të mëdha me bordin.
- Përfitim i përfaqësimeve nga anëtarët e bordit sa i përket plotësisë së të hyrave.
- Shpenzimet
- Merrni një tabelë të shpenzimeve të ndara për ngjarjet e grumbullimit të fondeve dhe kontrolloni nëse natyra e kostove është e arsyeshme.
- Për një mostër të shpenzimeve gjurmoni konston deri te fatura mbështetëse dhe dokumentet tjera.
- Krahasoni nivelin e përgjithshëm të shpenzimeve me vitin e kaluar dhe buxhetin. Diskutimi i luhatjeve të mëdha me menaxhmentin.
- Për një mostër të shpenzimeve kryesore konfirmoni se shpenzimet janë autorizuar nga anëtarët e bordit.

Detyra 2

(a) Përveç përparësive që i kanë të gjitha format e auditimit, një auditim jo - ligjor ka dhe përparësi të tjera.

Kërkohet

Numëroni TRE përparësi të auditimit jo - ligjor të një partneriteti

(6 pikë)

(b) SNA 610 Përdorimi i punës së auditorëve të brendshëm ofron udhëzime për auditorët e jashtëm mbi përdorimin e punës së auditimit të brendshëm.

Kërkohet

Listoni dhe shpjegoni shkurt kriteret e ndryshme të cilat duhet të konsiderohen nga auditorët e jashtëm kur vlerësohet nëse mund të mbështeten në punën e kryer nga auditorët e brendshëm. **(4 pikë)**

(c) Listoni katër shembuj të dëshmive të auditimit të cilat mund të merren nga përdorimi i ekspertit të jashtëm. **(4 pikë)**

(d) ISA 620 Përdorimi i punës së ekspertit nga auditorët ofron udhëzime për auditorët të cilët mbështeten në punën e kryer nga një ekspert.

Kërkohet

Listoni faktorët të cilët duhet të konsiderohen nga auditori kur vlerësohet puna e kryer nga një ekspert dhe shpjegoni cilat veprime duhet të ndërmerren nga auditori nëse vjen në përfundim se rezultatet e punës së ekspertit nuk ofrojnë dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme ose nëse rezultatet nuk janë në pajtueshmëri me dëshmitë tjera të auditimit. **(6 pikë)**

(Total = 20 pikë)

Zgjidhje

a.

Për shembull, auditimi i pasqyrave financiare të një **partneriteti** mund të shihet se ka përparësitë e mëposhtme.

1. Ofron një mënyrë të **stabilizimit të marrëdhënieve** midis partnerëve **në pasqyrat financiare**.
2. Në rastet kur vihen në dispozicion pasqyrat financiare të audituara një gjë e tillë i bën **pasqyrat financiare më të pranueshme** për **autoritetet tatimore** sidomos për sa i takon fitimit të tatueshëm për një partner individual.
3. **Shitja** e biznesit ose **negociatat për kredi** ose **për sigurimin e mbitërheqjeve (overdraft - it)** bëhen më të lehta në rastet kur firma është e aftë të paraqesë pasqyra të audituara financiare.
4. Auditimi në emër të një '**partneri jo aktiv**' është shumë i dobishëm, meqenëse në përgjithësi një person i tillë nuk ka në dispozicion mënyra të tjera për të kontrolluar pasqyrat financiare të biznesit ose për të konfirmuar pjesën e fitimeve që i takojnë atij ose asaj.

b)

1. Kriteret të cilat duhet të konsiderohen kur vlerësohet mbështetja në punën e auditorit të brendshëm përfshinë:

Objektiviteti i funksionit

Auditori i jashtëm duhet të konsideroj se kujt i raporton auditori i brendshëm dhe nëse ai i nënshtrohet ndonjë përgjegjësie me konflikt, pengese ose ndalese. Kjo do të ndikojë në aftësinë e auditorëve të brendshëm për të komunikuar çështjet domethënëse.

Fushëveprimi i funksionit

Auditorët e jashtëm duhet të konsiderojnë shtirjen dhe natyrën e angazhimeve të kryera nga auditorët e brendshëm dhe veprimet e ndërmarra nga menaxhmenti si rezultat i raporteve të auditimit të brendshëm.

Kompetenca teknike

Auditorët e jashtëm duhet të konsiderojnë nëse auditorët e brendshëm kanë trajnimin dhe njohurinë e duhur teknike.

Kujdesi i duhur profesional

Auditorët e jashtëm duhet të konsiderojnë nëse puna e auditorëve të brendshëm është planifikuar, mbikqyrur, rishikuar dhe dokumentuar si duhet.

2. Dëshmitë /evidencat e auditimit që mund të përftohen nga një ekspert:

- Vlerësimi i pasurive siç është toka dhe ndërtesat, pajisjet dhe makineritë, veprat e artit, gurët e çmuar.
- Përcaktimi i sasive dhe gjendjeve fizike të pasurive
- Përcaktimi i shumave duke përdorur teknika ose metoda të specializuara, siç janë vlerësimet aktuariale
- Matja e punës që do të përfundohet ose ka përfunduar lidhur me kontratat në proces
- Mendimet ligjore sa i përket interpretimeve të marrëveshjeve, statuteve dhe rregulloreve

3. Faktorët që duhet të konsiderohen kur vlerësohet puna e kryer nga një ekspert në auditim:

- Relevanca dhe arsyeshmëria e punë dhe konsistenca me dëshmit tjera të auditimit
- Relevanca dhe arsyeshmëria e çfardo supozimeve dhe metodave të përdorura
- Relevanca, plotësia dhe saktësia e çfardo të burimi të të dhënave të përdorura

Nëse rezultatet e punë së ekspertit nuk ofrojnë dëshmi të mjaftueshme dhe të të përshtatshme ose nuk në konsistencë me dëshmitë e auditimit, auditori duhet të zgjedhë çështjen. Kjo mund të bëhet përmes diskutimeve me entitetin dhe ekspertin, duke zbatuar procedura shtesë të auditimit, përfshirjen e ndonjë eksperti tjetër, ose duke e modifikuar raportin e auditimit (kjo është zgjidhja e fundit vetëm nëse çështjet mbeten të pazgjidhura).

Detyra 3

(a) Përshkruani përgjegjësitë e auditorit dhe punën që auditori duhet ta kryejë lidhur me supozimin e vijimësisë së kompanisë. **(5 pikë)**

(b) Përshkruani raportet e mundshme që mund të lëshohen nga auditorët kur ka dyshim për aftësinë e kompanisë të mos përmbushë supozimin e vijimësisë; përgjigja juaj duhet të përshkruaj rrethanat në të cilat mund të lëshohen opinionet e tilla. **(5 pikë)**

Antena SHA është një kompani e madhe e telekomunikimit e cila është e listuar në bursë. Është kompani e cila financohet në masë të madhe nga kreditë, sikur kompani tjera të ngjashme, ka huazuar një shumë të madhe të parave për të paguar për licencë për operim të telefonisë mobile me një teknologji e cila nuk është dëshmuar e suksesshme. Çmimi i aksioneve të kompanisë ka rënë me 50% gjatë tre viteve të fundit dhe ka pasur disa herë ndryshime në menaxhmentin e lartë gjatë asaj periudhe. Ka pasur spekulime të konsiderueshme në shtyp lidhur me aftësinë e kompanisë për të mbijetuar dhe kështu të mos blihej nga rivali i saj. Ka pasur tre tentime nga kompani tjera për ta blerë atë mirëpo të gjitha të pasuksesshme, kryesisht për shkak se ofertuesit janë tërhequr për shkak të rënies së çmimit të aksioneve.

Kompania ka pasuri neto, por ka qenë e domosdoshme të kufizojë tej mase programet e saja të investimeve. Disa komentatorë kanë konsideruar se investimet janë të rëndësishme në rritjen e ardhshme të kompanisë, për deri sa komentatorë tjerë thonë që biznesi i kompanisë është stabil. Gjithashu ishte e nevojshme që kompania të ristrukturonte financimin. Shpalosje të detajuara të të gjitha këtyre çështjeve janë bërë në pasqyrat financiare. Nuk është bërë ndonjë referencë për statusin e vijimësisë në raportin e kaluar të auditorit dhe përkeqësimi i rrethanave në vitin aktual nuk është më i madh se që ishte vitin e mëparshëm.

Kërkohej

(c) Në bazë të informatave të ofruara më sipër, përshkruani raportin e auditorit që ju konsideroni që është i mundshëm të jepet në rastin e Antena SHA duke i dhënë arsyet tuaja. **(4 pikë)**

(d) Përshkruani vështirësitë me të cilat mund të ballafaqohet kompani Antena dhe auditorët e saj nëse raporti i auditimit të kompanisë do t'i referohej vështirësive me supozimin e vijimësisë. **(6 pikë)**

(Total = 20 pikë)

Zgjidhja

(a)

(i) *Përgjegjësitë*

Sipas SNA 570 auditori duhet të:

- Vlerësojë vlerësimin e menaxhmentit të aftësisë së entitetit të operojë sipas supozimit të vijimësisë
- Konsiderojë nëse ka ose mund të ketë ngjarje dhe kushte që mund të rrisin dyshimin e aftësisë së entitetit për të operuar sipas supozimit të vijimësisë
- Bisedojë me menaxhmentin për njohuritë lidhur me ngjarjet ose kushtet pas periudhës së vlerësimit që mund të rrisin dyshimin e aftësisë së entitetit për të operuar sipas supozimit të vijimësisë
- Përftojë evidencë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për pasiguritë materiale që mund të ekzistojnë nëse ngjarjet ose kushtet e identifikuara mund të rrisin dyshimin e aftësisë së entitetit për të operuar sipas supozimit të vijimësisë

(ii) *Puna e auditimit*

- Si pjesë e vlerësimit të përgjithshëm të rrezikut auditori duhet të konsiderojë nëse ka ndonjë ngjarje ose kushte që lidhen me rreziqet e biznesit të cilat mund të rrisin dyshimin e aftësisë së entitetit për të operuar sipas supozimit të vijimësisë
- Auditori duhet të vlerësojë procesin përmes së cilit menaxhmenti ka vlerësuar shëndetin e kompanisë. Auditori duhet të bisedojë dhe të kërkojë informata nga personat e ngarkuar me qeverisjen dhe të ekzaminojë dokumentet mbështetëse siç janë parashiket e parasë së gatshme dhe buxhetet.

- Auditori duhet të konsiderojë nëse periudha e përdorur nga menaxhmenti për të bërë vlerësimet e tThe auditor must consideryre është e mjaftueshme. Nëse periudha mbulon më pak se 12 muaj, auditori duhet të kërkojë nga menaxhmenti të zgjasë këtë periudhë për të mbukuar së paku 12 muaj pas datës së raportimit financiar.
- Auditori duhet të vlerësojë supozimet e përdorura nga menaxhmenti dhe të përcaktojë nëse janë të arsyeshme bazuar në faktet e ditura
- Në rastet kur janë identifikuar ngjarjet ose kushtet që mund të hedhin dyshim në aftësinë së entitetit për të operuar sipas supozimit të vijimësisë, auditori duhet të rishikojë planet e menaxhmentit për veprimet në të ardhmen dhe të grumbullojë evidence të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të konfirmuar nëse ekzistojnë pasiguri material. Kjo do të përfshijë:
 - Analizimin dhe diskutimin e rrjedhës së parasë dhe pasqyrat financiare të ndërmjetme
 - Rishikimin e kushteve të bonove dhe marrëveshjeve të kredive
 - Leximin e procesverbaleve të takimeve të aksionarëve dhe drejtorëve për ndonjë referencë për vështirësitë financiare
 - Bisedat me avokatët e kompanisë sa i përket ndonjë çështje gjyqësore
 - Vlerësimin e mundësisë së marrjes së fondeve shtesë
 - Rishikimin e ngjarjeve pas përfundimit të periudhës raportuese
- Auditori duhet të kërkojë përfaqësime të shkruara (deklaratat e menaxhmentit) nga menaxhmenti sa i përket planeve për veprimet në të ardhmen.

(b) Raportet e auditimit

- (i) Kur përdorimi i supozimit të vijimësisë është i përshtatshëm por nëse ekzistojnë pasiguri material, duke supozuar se auditori pajtohet me bazën e përgatitjes së pasqyrave financiare dhe nëse kjo situatë është shpalosur si duhet, jepet një opinion i **pamodifikuar**. Mirëpo raporti i auditimit duhet të përmbajë një paragraph të **theksimit të çështjes** në të cilin nënvizohet pasiguria.
- (ii) Kur ekziston pasiguri material por situatë nuk është shpalosur mjaftueshëm, opinionin duhet të **modifikohet** mbi bazën se nuk ka shpalosje të mjaftueshme dhe pasqyrat financiare përmbajnë anomali material. Varësisht nga rrethanat specifike, opinion mund të jetë me rezervë ‘përveç për’ ose i kundër.
- (iii) Nëse sipas gjykimit të auditorit kompania nuk do të jetë e aftë të vijojë sipas supozimit të vijimësisë dhe pasqyrat financiare janë përgatitur mbi bazën e vijimësisë, auditori duhet të jep një **opinion të kundërt**.
- (iv) Nëse auditori nuk është në gjendje të formojë një opinion sepse nuk ishte në gjendje të përftojë evidence të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori do të jep një opinion me reserve më ‘përveç për’ ose një refuzim të opinionit.
- (v) Nëse menaxhmenti nuk është i gatshëm të zgjas periudhën e vlerësimit në rastet kur periudha e vlerësimit është më e shkurtër se 12 muaj nga data e raportimit, auditori duhet të konsiderojë nevojën e modifikimit të opinionit si rezultat i mospërfutimit të evidencave

(c) Reportet e lëshuara për Anita Shpk

Edhe pse kompania dukshëm është duke u ballafaquar me disa vështirësi, evidence e ofruar nuk sugjeron se biznesi do ta ndërpresë aktivitetin në një të ardhme të afërt. Kompania ka asete noeto dhe ende duket të ketë opsione në dispozicion për të zgjidhur problemet. Fakti që kompania ka ndërmarrë hapa për të rishturuar financimin dhe ishte në gjendje të bënte këtë, është shenjë positive.

Mbi bazën se situata nuk është më e keqe se në vitet e mëparshme dhe nuk i është bërë ndonjë referencë supozimit të vijimësisë në të kaluarën, nuk është e përshtatshme ti referohemi këtë vit. Do të leshohet një opinion i pamodifikuar i auditimit.

(d) Vështirësitë

Nëse raporti i auditimit përmend problemin me vijimësinë ka mundësi që kompania ta ketë vështirë të merr financim dhe konsumtaroët dhe furnitorët mund të jenë më të kujdesshëm në të bërit biznes me kompaninë.

Marrëdhënia në mes të auditorit dhe menaxhmentit të kompanisë mund të ndërlikohet sidomos nëse menaxhmenti beson se nuk ka nevojë të bëhet ndonjë referencë lidhur me problemin me vijimësisë. Kjo veçanërisht është e vështirë pasi që kjo është çështje që kërkon gjykim dhe rrallë mund të ketë një vendim të prerë. Në rrethana ekstreme auditorët mund të humbin tarifat e auditimit nga këto angazhime.

Pasi që nuk ka pasur referencë lidhur me vijimësinë në të kaluarën, nëse përmendet këtë vit do të thotë se situata është përkeqësuar ose raporti i vitit të kaluar nuk ishte i saktë.

Detyra 4

Ju jeni angazhuar të auditoni pasqyrat financiare të përgatitura sipas SNRF për vitin që përfundon me 31 dhjetor 2013 të kompanisë Module, një prodhues i lodrave. Asistentët tuaj ju kanë ofruar informatat në vijim:

- (i) Pasqyrat financiare draft të kompanisë paraqesin €250,000 në llogari bankare, €1,744,000 të arkëtueshme, €1,441,000 në stoke, €3,600,000 të pagueshme. Shitjet ishin €7,325,000 dhe gjithsej shpenzime €7,725,000;
- (ii) Në javën e parë të janarit, njëra nga depot e kompanisë ishte djegur nga zjarri dhe kjo ngjarje është duke u hetuar nga policia si zjarrvënie e qëllimshme. Kompania e sigurimit do të mbulojë rreth 60% të humbjes së stokeve sipas vlerës në libra të tyre;
- (iii) Menaxhmenti i kompanisë ju ka informuar se nuk dëshirojnë që ju të kontaktoni konsumatorët e saj me letra të konfirmimit pasi që kjo do t'i shqetësojë ata dhe të të ndikojë në marrëdhënien me konsumatorët. Në vend të kësaj, menaxhmenti ka kërkuar nga ju të kryeni procedura alternative të auditimit së bashku me përfitim të letrës së përfaqësimit (deklarata e menaxhmentit) nga menaxhmenti;
- (iv) Kompania përdor metodën FIFO për vlerësimin e stokeve dhe të gjitha stoqet janë vlerësuar me kosto të blerjes. Kompania paraqet si shpenzim të veçantë koston e transportit të stokeve të blera. Siç ka shpjeguar menaxhmenti, kjo bëhet për shkak se duan të arrijnë një vlerësim transparent të stokeve dhe trajtim konservativ të shpenzimeve.

Kërkohet:

- a) Analizoni çështjet e mësipërme duke shpjeguar efektin e tyre në pasqyrat financiare dhe në punën e auditimit. **(12 pikë)**
- b) Shpjegoni qëllimin e përfitimit të letrës së përfaqësimit dhe rëndësinë e saj si dëshmi e auditimit. **(4 pikë)**
- c) Shpjegoni qëllimin dhe llojet e letrave të konfirmimit të llogarive të arkëtueshme. **(4 pikë)**

(Total = 20 pikë)

Zgjidhja

a)

- (i) Kompania ka një kapital qarkullues negativ dhe ka gjeneruar humbje. Për deri sa kjo nuk do të jetë tregues i domosdoshëm i problemit me vijimësinë e kompanisë, duhet të kryhet më shumë punë gjatë auditimit të kësaj kompanie.
- (ii) Zjarri në depo – të hyrat nga kompania e sigurimit do të mbulojnë vetëm 60% të humbjes së stokeve; kjo ngjarje pasuese duhet të shpalolet në shënimet e pasqyrave financiare. Përveç kësaj, humbja do të ndikojë po ashtu në supozimin e vijimësisë së kompanisë.
- (iii) Kërkesa për konfirmime të shkruara të llogarive të arkëtueshme është procedurë e auditimit (SNA 505). Nëse menaxhmenti refuzon të lejojë auditorët të dërgojnë kërkesa për konfirmim, auditori duhet të: (a) Pyetni menaxhmentin lidhur me arsyet për refuzim dhe kërko dëshmi të auditimit për vlefshërinë dhe arsyeshmërinë; (b) Vlersëo pasojat e këtij refuzimi në vlerësimin e anomalive material, përfshirë rrezikun nga mashtrimet, natyrën kohën dhe shtrirjen e procedurave tjera të auditimit; dhe (c) kryej procedura alternative të

auditimit të dizajnuara për të përfutur dëshmi relevante dhe besueshme të auditimit. Nëse auditori konkludon se refuzimi i menaxhmentit për të lejuar auditorin të dërgoj kërkesa për konfirmim është i paarsyeshëm, ose auditori nuk është në gjendje të përftojë dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit nga procedurat alternative të auditimit, auditori duhet të komunikojë me personat e ngarkuar me qeverisjen në pajtueshmëri me SNA 260. Auditori po ashtu do të përcaktojë pasojat e kësaj çështjeje në opinionin e auditimit në pajtueshmëri me SNA 705. *Përfaqësimet e menaxhmentit diksutohen në seksionin b)*

(iv) SNK 2 Stoqet thekson: “Kosto e blerjes së stoqeve përbëhet nga çmimi blerës, doganat dhe taksat tjera (përveç atyre të cilat llogariten më vonë me autoritetet tatimore), dhe *transporti, bartja dhe kosto tjera të atribuueshme në blerje të mallrave të gatshme, materialeve dhe shërbimeve*. Zbritjet tregtare dhe zërat e ngjashëm zbriten nga vlera për të përcaktuar koston e blerjes. Prandaj, argumenti i menaxhmentit për “transparencë” më të madhe nuk është relevant;

b) Qëllimi: SNA 580 Përfaqësimet e shkruara, thekson: “Auditori duhet të kërkojë përfaqësimet të shkruara nga personat e ngarkuar me qeverisjen që kanë përgjegjësi të duhur për pasqyrat financiare dhe që kanë njohuri për çështjet përkatëse.” – përfaqësimet e shkruara paraqesin pranimin e përgjegjësisë nga personat e ngarkuar me qeverisjen (në rastin tonë, menaxhmentit) për pasqyrat financiare dhe çështjet përkatëse.

Rëndësia: SNA 580: “Edhe pse përfaqësimet e shkruara ofrojnë dëshmi të domosdoshme të auditimit, ato të vetme nuk ofrojnë dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për cilëndo çështje të cilën e adresojnë. “Prandaj, auditori duhet të përftojë dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit nga burimet tjera; përfaqësimet e shkruara mund të konsiderohen vetëm si dëshmi shtesë.

c) Qëllimi: SNA 505 Konfirmimet e jashtme thekson se “dëshmia e auditimit në formën e konfirmimeve të jashtme të pranuar direkt nga auditori nga palët konfirmuese mund të jetë më e besueshme se sa dëshmia e gjeneruar së brendshme nga entiteti.” Kjo për faktin se dëshmia përftohet nga auditori direkt nga palët e treta.

Llojet:

Pozitive – “pala që konfirmon përgjigjet direkt te auditori duke treguar nëse pajtohet ose jo me informatën e kërkuar, ose ofron informatën e kërkuar.”

Negative – “pala që konfirmon përgjigjet direkt te auditori vetëm nëse nuk pajtohet me informatën e kërkesës për konfirmim.”

Detyra 5

Aphid Shpk një prodhues i pijeve joalkoolike ka zhvlerësuar pasisjet e saj brenda periudhës së jetës së përdorimit prej 8 vitesh, duke përdorur metodën lineare (drejtvizore) të zhvlerësimit. Kosto e pajisjeve ishte €400,000 dhe zhvlerësimi vjetor ishte €50,000. Vlera e mbetur në fund të jetës së përdorimit ishte 0. Pas katër vitesh është përcaktuar se jeta e përdorimit ishte vetëm 2 vjet.

Kërkohet:

- a) Analizoni shkurtimisht skenarin dhe shpjegoni trajtimin e duhur. (5 pikë)
- b) Cilat janë objektivat e auditimit të vlerësimeve kontabël të bëra nga menaxhmenti? (3 pikë)
- c) Listoni KATËR pohime relevante gjatë auditimit të pasurive jo-qarkulluese të trupëzuara dhe përshkruani një procedurë të auditimit e cila ofron dëshmi për secilin pohim. (8 pikë)
- d) ISA 500 Dëshmitë e auditimit kërkon që dëshmia të jetë e besueshme.

Kërkohet:

Listoni KATËR faktorë që ndikojnë në besueshmërinë e dëshmive të auditimit. (4 pikë)

Total = 20 pikë

Zgjidhja

a) SNK-të e zbatueshme për këtë çështje janë SNK 16 Prona, impinatet dhe pajisjet dhe SNK8 Politikat kontabël, ndryshimet në vlerësimet kontabël dhe gabimet. Jeta e përdorimit të një pasurie është një vlerësim i bazuar në gjykimin e menaxhmentit. Nëse jeta e përdorimit të një pasurie ndryshon, kjo përbën ndryshim në verësimin kontabël dhe si e tillë zbatohet në mënyrë prospektive. Prandaj, shuma e zhvlerësueshme pas katër vitesh, EUR 200,000 duhet të zhvlerësohet përgjatë pjesës së mbetur të jetës së përdorimit të pasurisë, dmth 2 vite.

b) SNA 540 Auditimi i vlerësimeve kontabël, përfshirë vlerësimet nga kontabiliteti i vlerës fer (të drejtë) dhe shpalosjet përkatëse paraqet udhëzimet për auditimin e vlerësimeve kontabël.

Objektiva e auditorit është të përftojë dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit nëse: (a) vlerësimet kontabël, përfshirë vlerësimet nga kontabiliteti i vlerës fer, në pasqyrat financiare, të njohura ose të shpalosura, janë të arsyeshme; dhe (b) shpalosjet përkatëse në pasqyrat financiare janë të mjaftueshme në kontekstin e kornizës së raportimit financiar.”

c)

- **Plotësia** – siguroni se të gjitha pasuritë joqarkulluese janë regjistruar në regjistrin e pasurive joqarkulluese duke përpunuar një mostër të pasurive të verifikuar fizikisht me regjistrin e pasurive.
- **Ekzistenca** – siguroni se pasuritë joqarkulluese ekzistojnë duke marrë një mostër të pasurive nga regjistri dhe duke e inspektuar pasurinë fizike.
- **Vlerësimi dhe shpërndarja** – siguroni se pasuritë janë vlerësuar si duket duke kontrolluar arsyeshmërinë e llogaritjeve të zhvlerësimit.
- **Të drejtat dhe obligimet** – siguroni se kompania zotëron pasuritë duke shikuar dokumentet e duhura të pronësisë psh, një faturë të blerjes.
- **Paraqitja dhe shpalosja** – siguroni se të gjitha shpalosjet e duhura në pasqyrat financiare janë bërë duke rishikuar pasqyrat financiare dhe siguroni se të gjitha pasuritë janë kategorizuar në ato pasqyra financiare.

d) Faktorët në vijim ndikojnë në besueshmërinë e dëshmive të auditimit:

- (i) Dëshmia e auditimit është më e besueshme kur merret nga burimet e pavarura jashtë kompanisë.
- (ii) Dëshmia e auditimit e cila gjenerohet brenda kompanisë është më e besueshme nëse kontrollet përkatëse janë efektive.
- (iii) Dëshmia e auditimit që përfitohet direkt nga auditori (psh vëzhgimi i zbatimit të një kontrolli) është më e besueshme se sa dëshmia që merret në mënyrë indirekte (psh nga bisedat me menaxhmentin)
- (iv) Dëshmia e auditimit është më e besueshme kur ekziston në formë të dokumentuar, letër, formë elektronike ose ndonjë medium tjetër. (Psh, procesverbalet e shkruara janë më të besueshme se prezantimi i diskutimeve në mënyrë orale).
- (v) Dëshmia e auditimit që ofrohet në dokumente origjinale është më e besueshme se dëshmia e auditimit nga fotokopjes ose faksimilet.

Shembuj tjerë janë:

- (vi) Dëshmia që krijohet gjatë funksionimit normal të biznesit është më e besueshme se dëshmia që krijohet vetëm për ta kënaqur auditorin.
- (vii) Burimi më së miri i informuar për dëshmitë e auditimit normalisht është menaxhmenti (edhe pse mungesa e pavarësisë së menaxhmentit mund ta zvogëlojë vlerën e këtij burimi të dëshmisë).